



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

**Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:**

IP Burgu Shkup - Shkup, llogaria e buxhetit themelor (603) për vitin 2020.

**Lënda e revizionit:**

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë.

**Qëllimi i revizionit:** Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore relevante.

**Gjendjet kyçe të konstatuara:**

- sektori për risocializim nuk është i ekipuar mjaftueshëm me çka shpie në dyshim procesin e risocializimit të suksesshëm të personave të dënuar;
- nuk është caktuar person për të kontrolluar cilësinë e ushqimit gjatë ndarjes së ushqimeve;
- nuk është vendosur evidentimi i kontabilitetit për mjetet materiale me të cilat disponon institucioni.

**Mendimi i dhënë/përfundimi \*:**

Shprehëm mendim të pavolitshëm për vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe mendim me rezervë për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

**Rekomandimet kyçe:**

- Për trajtimin efikas dhe risocializimin e personave të dënuar, personi përgjegjës duhet të kryejë ekipimin adekuat të Sektorit të risocializim, a në pajtim me kërkesat e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës;
- Personi përgjegjës të marrë masa se personat të cilët janë caktuar ta kryejnë kontrollin e ushqimit të veprojnë në pajtim me detyrat e përcaktuara me vendim.

**Dobësitë kyçe të sistemit:**

/

**Përgjigjet e vërejtjeve të marra:**

/

**Vërejtjet e marra të draft-raportit:**

Nuk janë marrë vërejtje për draft-raportin e revizorit të autorizuar shtetëror.

\* pozitive me rezervë të pavolitshëm të përmbajtur